KËSHILLI I EUROPËS

GJYKATA EUROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

ÇËSHTJA BAJRAMI KUNDËR SHQIPËRISË
(ANKIMI NR. 35853/04)

SEKSIONI I KATËRT

VENDIM
STRASBURG

12 DHJETOR 2006

Ky vendim merr formë të prerë në rrethanat e përcaktuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktues.

Në çështjen Bajrami kundër Shqipërisë,

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i katërt), me trup gjykues të përbërë nga:
z. Nicolas BRATZA, President
z. G. BONELLO
z. M. PELLONPAA
z. K. TRAJA
z. L. GARLICKI
z. L. MIJOVIC
z. J. SIKUTA, gjykatës
dhe z. T.L. EARLY, regjistrues i seksionit,
pas shqyrtimit me dyer të mbyllura të çështjes më 10 tetor 2006 dhe më 21 nëntor 2006,
shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u mor në datën e fundit të përmendur:

PROCEDURA

1. Çështja e nisur me ankesën (nr. 35853/04) kundër Republikës së Shqipërisë, depozituar në Gjykatë në bazë të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ("Konventa") nga një shtetas etnik shqiptar nga Kosova, z. Agim Bajrami ("Ankuesi"), më 27 shtator 2004.

2. Ankuesi u përfaqësua nga znj. E. Murataj, avokate, e cila e ushtronte profesionin në Fier. Pala Shqiptare ("Qeveria") u përfaqësua nga agjenti i saj, z. S. Puto, nga Ministria Punëve të Jashtme.

3. Më 14 mars 2005 Gjykata vendosi të njoftonte autoritetet shqiptare për ankesën. Sipas dispozitave të nenit 29 § 3 të Konventës, ajo vendosi të shqyrtonte themelin e ankimit dhe pranueshmërinë e tij në të njëjtën kohë.

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

4. Ankuesi ka lindur më 1964 dhe jeton në Caralevë, në bashkinë e Shtimës (Kosovë).

5. Më 28 prill 1993 ankuesi u martua me F.M., shtetase shqiptare. Çifti kishte një fëmijë, I.B., i cili kishte lindur më 20 janar 1997. Në vitin 1998 ankuesi dhe F.M. u ndanë.

6. F.M., së bashku me vajzën e saj, u transferuan në shtëpinë e prindërve të saj në Vlorë, Shqipëri.

7. Më 6 maj 1999, bashkëshortja e ankuesit u martua me një person tjetër, duke përdorur dokumente të falsifikuara, pa u divorcuar me ankuesin.

8. Rezulton që më 15 shtator 1999, Gjykata e Rrethit Vlorë anuloi martesën e dytë të F.M-së. Në një datë të pacaktuar, ajo u martua me H.I., shtetas shqiptar që banonte në Greqi.

9. F.M udhëtonte shpesh në Greqi, gjatë viteve të martesës së tretë, duke e lënë të bijën për një kohë të gjatë me prindërit e saj në Vlorë, ose duke e marrë në Greqi me vete pa pëlqimin e ankuesit.

10. F.M. dhe prindërit e saj e kishin ndaluar ankuesin të takohej me të bijën. Që pas ndarjes me F.M., ankuesi është lejuar të takohet me të bijën vetëm dy herë, në shtator 2000 dhe maj 2003.

1.Procedurat e divorcit dhe kujdestarisë

11. Më 24 qershor 2003 ankuesi filloi procesin e divorcit në Gjykatën e Rrethit Vlorë.

12. Më 26 qershor 2003 ankuesi i kërkoi policisë së rrethit Vlorë të bllokonte pasaportën e së bijës për faktin se bashkëshortja e tij po planifikonte ta merrte atë në Greqi pa pëlqimin e tij.

13. Pavarësisht nga kërkesa e ankuesit drejtuar policisë së rrethit Vlorë, rezulton që e shoqja e mori fëmijën në Greqi më 15 janar 2004, duke përdorur një certifikatë zyrtare, ku e bija e ankuesit ishte regjistruar me emrin I.M. dhe përdorte mbiemrin e F.M.-së

14. E shoqja e ankuesit nuk ishte e pranishme në seancë. I ati i kësaj të fundit dëshmoi në seancë që mbesa e tij ishte në Greqi me të ëmën, e cila banonte atje si refugjate ekonomike.

15. Më 4 shkurt 2004 Gjykata e Rrethit Vlorë vendosi divorcin e palëve. Gjykata i dha ankuesit kujdestarinë e fëmijës, duke marrë në konsideratë mungesën e interesit të bashkëshortes për jetën e fëmijës, paqëndrueshmërinë e vendbanimit të saj dhe periudhat e gjata të ndarjes nga fëmija.

16. Më 19 mars 2004 vendimet e divorcit dhe kujdestarisë morën formë të prerë.

2.Procedurat e ekzekutimit

17. Më 5 prill 2004 Gjykata e Rrethit Vlorë nxori urdhër me shkrim për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Vlorë të 4 shkurtit 2004.

18. Më 13 korrik 2004 zyra e përmbarimit në Vlorë e njoftoi ankuesin se ishte e pamundur të zbatonte vendimin, duke qenë se fëmija nuk ndodhej në Shqipëri.

19. Më 15 gusht 2004 dhe 13 janar 2005 ankuesi iu drejtua Ministrisë shqiptare të Drejtësisë të siguronte kthimin e së bijës.

20. Më 11 janar 2005, kur u mor në pyetje nga përmbaruesit, i ati i F.M-së deklaroi se F.M. dhe fëmija jetonin jashtë shtetit dhe se ai nuk kishte dijeni në lidhje me vendndodhjen e tyre. Gjatë periudhës janar -maj 2005, përmbaruesit u paraqitën tre herë në shtëpinë e F.M.-së.

21. Në maj 2005, rajoni i policisë së rrethit Selenicë njoftoi përmbaruesit se F.M. dhe e bija nuk jetonin në Athinë dhe se i ati i F.M.-së ishte transferuar në Tiranë në një adresë të panjohur.

22. Në korrik 2005 zyra e përmbarimit njoftoi ankuesin, se për të vepruar në përputhje me marrëveshjet dypalëshe ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë, ai duhej të paraqiste një kërkesë dhe të jepte adresën e saktë të fëmijës në Greqi.

23. Ankuesi u dërgoi kërkesa të shumta autoriteteve shqiptare, Ambasadës Greke në Shqipëri, Avokatit të Popullit të Shqipërisë dhe Avokatit të Popullit të Kosovës, duke kërkuar ndihmë në sigurimin e ekzekutimit të vendimit të kujdestarisë.

3. Procedim penal për rrëmbim fëmije

24. Më 14 gusht 2004 ankuesi nisi procedimin penal pranë Gjykatës së Rrethit Vlorë kundër ish- bashkëshortes së tij, duke e akuzuar atë për rrëmbim fëmije.

25. Më 13 tetor 2004 Gjykata e Rrethit Vlorë njoftoi Avokatin e Popullit se nuk ishte depozituar asnjë padi në lidhje me rrëmbimin e së bijës së ankuesit.

4. Procedimi penal kundër A.C.

26. Më 15 dhjetor 2003 ankuesi filloi procedimin penal kundër A.C.-së, punonjëse e Zyrës së Gjendjes Civile. Ai e akuzonte atë për falsifikim të dokumenteve të ndryshme që i kishin mundësuar F.M.-së të largonte I.B.-në nga Shqipëria, e veçanërisht për falsifikimin e dokumenteve që e deklaronin bashkëshorten e tij të pamartuar dhe ndërrimin e mbiemrit të së bijës.

27. Më 26 janar 2004 Gjykata e Rrethit Vlorë vendosi të ndërpriste gjykimin.

5. Zhvillimet e fundit

28. Më 22 gusht 2006 autoritetet shqiptare njoftuan zyrën e regjistrit se më 31 mars 2006, Gjykata e Apelit në Vlorë kishte shfuqizuar vendimin e kujdestarisë të 4 shkurtit 2004, me arsyetimin se F.M.-ja nuk ishte njoftuar rregullisht në lidhje me gjykimin për kujdestarinë e të bijës. Kjo gjykatë vendosi t'ia dërgonte çështjen Gjykatës së Rrethit për t'u marrë sërish në shqyrtim dhe si rezultat gjykimi i kujdestarisë ka mbetur ende pezull.

29. Më 23 gusht 2006, në bazë të kërkesës së zyrës së regjistrit, ankuesi deklaroi se ai nuk ishte njoftuar për fillimin e një procesi të ri dhe as për rezultatet e tij.

30. Gjykimi ishte filluar nga avokati i F.M.-së dhe ishte zhvilluar në mungesë të ankuesit.

LEGJISLACIONI PËRKATËS NDËRKOMBËTAR DHE I BRENDSHËM

A. Legjislacioni ndërkombëtar përkatës

1.Konventa e Hagës mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve

31. Aktualisht, Shqipëria nuk e ka ratifikuar Konventën e Hagës të 25 tetorit 1980 mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve.

2. Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Të Drejtat e Fëmijëve

32. Neni 11 i Konventës mbi Të Drejtat e Fëmijëve e 20 nëntorit 1989, i ratifikuar nga Shqipëria më 27 shkurt 1992, kërkon nga shtetet palë të marrin masa për të luftuar transferimin e paligjshëm dhe moskthimin e fëmijëve jashtë shtetit. Për këtë qëllim, shtetet duhet të nxitin lidhjen e marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe ose aderimin në marrëveshjet ekzistuese.

3.Marrëveshjet Dypalëshe mbi Ndihmën e Ndërsjellë për Çështjet Civile dhe Penale ndërmjet Greqisë dhe Shqipërisë

33. Kjo Marrëveshje, e nënshkruar më 17 maj 1993, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 7760, datë 14 tetor 1993 dhe nga Greqia sipas ligjit nr.2311/1995.

Nenet 2, 3, 23 dhe 24 të Marrëveshjes parashikojnë mundësinë për Ministritë e Drejtësisë së të dyja Palëve Kontraktuese për të bashkëpunuar për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në territoret e tyre respektive në lidhje me çështjet civile, familjare dhe tregtare.

B. Legjislacioni dhe praktika përkatëse e brendshme

34. Kodi i Procedurës Civile, i cili rregullon, ndër të tjera, ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë, nuk përmban ndonjë dispozitë veçanërisht të zbatueshme për transferimin e kujdestarisë së fëmijëve. Si rezultat, rregullat e përgjithshme procedurale mbi ekzekutimin e vendimeve zbatohen *mutatis mutandis*.

35. Në ato raste kur refuzimi për t'u bindur i një prej prindërve përbën vepër penale, çështja duhet t'i dërgohet organit të ndjekjes penale.

36. Mosrespektimi i vendimit të formës së prerë për kujdestarinë e fëmijës mund të ndëshkohet në bazë të nenit 127 të Kodit Penal.

LIGJI

I.KUNDËRSHTIMI PARAPRAK I QEVERISË

37. Pala shqiptare pretendoi se ankuesi nuk i kishte ezauruar të gjitha mjetet e mbrojtjes ligjore të brendshme në dispozicion të tij. Ata argumentonin se ankuesi nuk kishte ngritur çështjen e mosveprimit të zyrës së përmbarimit pranë Gjykatës së Rrethit Vlorë në përputhje me nenin 610 të Kodit të Procedurës Civile. Në bazë të parashtrimeve të autoriteteve shtetërore, dispozita përkatëse u jep individëve të drejtën të kundërshtojnë veprimet e përmbaruesve para Gjykatës së Rrethit. Si rrjedhim, ankuesi nuk ka mundur të përfitojë nga kjo e drejtë, pavarësisht se i ishte drejtuar Ministrisë së Drejtësisë dhe autoriteteve të tjera për mosveprim nga ana e përmbaruesve.

38. Ankuesi kundërshtoi efikasitetin e këtij mjeti të brendshëm, në bazë të parashtrimeve të autoriteteve shtetërore. Ai argumentoi se një ankim tjetër nuk do ta arrinte qëllimin e tij kryesor, d.m.th, ta ribashkonte atë me të bijën. Ai theksoi, se gjatë dy viteve që pasuan marrjen e vendimit të kujdestarisë, ai u kishte drejtuar disa kërkesa organeve kompetente. Kjo përfshinte fillimin e procedimit penal për rrëmbimin e fëmijës së tij, si dhe kërkesat e vazhdueshme për ekzekutimin e menjëhershëm të vendimit në interes të së bijës. Si rrjedhim, ankuesi parashtroi se deklaratat e autoriteteve shtetërore ishin të pabazuara.

39. Gjykata thekson se qëllimi i nenit 35 është t'u ofrojë Shteteve Kontraktuese mundësinë e parandalimit ose vënies në vend të shkeljes së pretenduar kundër tyre, para se këto pretendime t'i paraqiteshin asaj (si për shembull, Hentrich v. France, vendimi i datës 22 Shtator 1994, Seria A nr. 296-A, fq. 18, § 33, dhe Remli v. France, vendimi i datës 23 prill 1996, Reports of Judgments and Decisions

1996-II, f. 571, § 33). Si rezultat, ankimi që duhet të paraqitet në Gjykatë duhet në radhë të parë të paraqitet para gjykatave përkatëse kombëtare, të paktën në përmbajtje, në përputhje me kërkesat formale të së drejtës së vendit dhe brenda afateve të paracaktuara me ligj. Megjithatë, të vetmet mjete të brendshme, që duhet të ezaurohen janë ato që lidhen me shkeljet e supozuara dhe që në të njëjtën kohë janë të mundshme dhe të mjaftueshme. Ekzistenca e mjeteve të tilla të brendshme duhet të jetë mjaft e sigurt, jo vetëm në teori, por dhe në praktikë, dhe nëse nuk janë të tilla, ato nuk ofrojnë aksesin dhe efikasitetin e duhur. Në këtë kuadër, i takon shtetit përkatës të vërtetojë plotësimin e këtyre kushteve të ndryshme (shih, në veçanti, Vernillo v. France, vendimi i datës 20 shkurt 1991, Seria A nr. 198, fq. 11 – 12, § 27, dhe Akdivar and Others v. Turkey, vendimi i datës 16 shtator 1996, Reports 1996-IV, fq. 1210-11, § § 65-68).

40. Gjykata tërheq vëmendjen se ankuesi është ankuar që autoritetet kanë neglizhuar të ndërmarrin masat e nevojshme për të zbuluar vendndodhjen e së bijës, në zbatim të vendimit të kujdestarisë në favor të tij.

41. Në favor të ankuesit u nxor një urdhër gjyqësor për ekzekutimin e vendimit të datës 4 shkurt 2004 në përputhje me kërkesat e procedurave civile të vendit, por përmbaruesit ishin të paaftë ta zbatonin atë, meqenëse e bija e ankuesit nuk gjendej më në Shqipëri.

42. Gjykata konstaton se autoritetet shqiptare nuk kanë mundur të provonin argumentin e tyre që mjeti i brendshëm i sipërpërmendur është i mundshëm dhe i përshtatshëm për të ndrequr shkeljen e pretenduar.

43. Veç kësaj, Gjykata vëren se për një çështje të ngjashme kundër shtetit shqiptar ajo evidentoi se sistemi ligjor shqiptar ishte organizuar në një mënyrë të tillë, që nuk siguron mjete të brendshme efektive kundër veprimeve të përmbaruesve, duke qenë se Gjykata Kushtetuese arsyetonte, se nuk kishte bazën ligjore për të shqyrtuar ankesa lidhur me procedurat e ekzekutimit të vendimeve dhe i deklaronte ato sistematikisht të papranueshme (shih Qufaj Co. sh.p.k. v. Albania, nr. 54268\00, § 41, më 18 nëntor 2004). Në çdo rast, u takonte organeve kompetente të garantonin ekzekutimin e vendimeve gjyqësore duke qenë se janë ato që kanë mjetet e nevojshme ligjore dhe burimet për të zbuluar vendndodhjen e fëmijës dhe për të siguruar kthimin e saj. Në këto rrethana, nuk mund të pretendohet se ankuesi duhej t'u bënte kërkesa të përsëritura përmbaruesve ose të ankohej për mosveprimin e tyre tek një gjykatë për të arritur ekzekutimin e vendimit.

44. Si rrjedhim, Gjykata konkludon që në kohën e duhur, mjetet e brendshme të referuara nga autoritetet shtetërore nuk i ofruan ankuesit perspektivë të arsyeshme suksesi.

45. Prandaj, kundërshtimi paraprak i autoriteteve shtetërore duhet të mos pranohet.

II. SHKELJE TË PRETENDUARA TË NENIT 8 TË KONVENTËS

46. Ankuesi është ankuar se mungesa e efektivitetit të organeve kompetente shqiptare në pamundësinë për të marrë masat e nevojshme për ribashkimin e tij me të bijën në përputhje me vendimin e formës së prerë kishin shkelur të drejtën e tij të respektimit të jetës familjare, sipas nenit 8 të Konventës, i cili parashikon si më poshtë:

1. "Çdo person ka të drejtë që t'i respektohet jeta e tij private dhe familjare, vendbanimi dhe korrespondenca e tij''

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, vetëm në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur në një shoqëri demokratike, kjo masë është e domosdoshme për sigurimin kombëtar, për sigurimin publik, për mirëqenien ekonomike të vendit, për mbrojtjen e rendit ose për parandalimin e veprave penale, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.

A. Pranueshmëria

47. Gjykata vëren se ankimi nuk është haptazi i pabazuar sipas kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Ajo thekson më tej se ai nuk është i papranueshëm për ndonjë shkak tjetër. Për këtë arsye, duhet të deklarohet i pranueshëm.

B.Themeli

1.Parashtrimet e palëve

48. Ankuesi u ankua se organet kompetente kishin neglizhuar të bënin ato përpjekje që priteshin normalisht prej tyre për të garantuar respektimin e të drejtave të tij. Ai pretendonte gjithashtu që edhe dështimi i organeve kompetente për të përfshirë edhe organet përkatëse greke në ndihmë të gjetjes së

vendndodhjes të së bijës bazohej në supozimin e tyre se F.M. dhe bashkëshorti i saj aktual ishin rezidentë të paligjshëm në Greqi dhe nuk mbështetej mbi fakte të bazuara.

49. Autoritetet shqiptare kundërshtuan argumentet e ankuesit. Ato deklaruan se në përputhje me detyrimet pozitive sipas nenit 8 të Konventës, organet kompetente kishin marrë të gjithë hapat e mundshëm në dispozicion të tyre për të bashkuar ankuesin me të bijën. Ata theksuan se në Greqi jetonin afërsisht 500 000 shtetas shqiptarë dhe se gjysma e tyre banonin atje në mënyrë të paligjshme. Prandaj, shteti nuk mund të mbante përgjegjësi për pamundësinë e ankuesit për të dhënë detaje të sakta të vendndodhjes të së bijës dhe për të kërkuar marrjen e masave urgjente para se F.M.-ja të largohej nga Shqipëria, duke marrë edhe fëmijën e saj me vete. Autoritetet shtetërore argumentonin se, meqenëse nuk ishte dhënë adresa e saktë e fëmijës dhe nënës së saj në Greqi, përdorimi i instrumenteve të parashikuara në marrëveshjen dypalëshe ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë kishte qenë jo efikas (shih paragrafin 33 më sipër).

2. *Vlerësimi i Gjykatës*

a) Parime të përgjithshme

50. Gjykata rithekson se qëllimi kryesor i nenit 8 është të mbrojë individin prej veprimeve arbitrare të autoriteteve publike. Përveç kësaj, ka detyrime pozitive të qenësishme për "respektimin" efektiv të jetës familjare. Në të dy kontekstet duhet të ketë një ekuilibër të drejtë ndërmjet interesave konkurruese të individit dhe komunitetit në tërësi; dhe në të dy kontekstet shteti gëzon një liri të caktuar vlerësimi (shih Keegan v. Ireland, vendimi i datës 26 maj 1994, Seria A nr. 290, f. 19, § 49; Ignaccolo-Zenide v. Romania, no. 31679/96, § 94, ECHR 2000-I; Iglesias Gil and A.U.I. v. Spain, no. 56673/00, § 49, ECHR 2003-V; and Sylvester v. Austria, no. 36812/97, 40104/98, § 51, 24 April 2003).

51. Përsa i përket detyrimit të shtetit për të marrë masa pozitive, Gjykata ka arsyetuar vazhdimisht se neni 8 përfshin të drejtën e prindit në marrjen e masave me qëllim ribashkimin e tij me fëmijën dhe detyrimin e organeve shtetërore për të lehtësuar këtë ribashkim (shih, ndër autoritetet e tjera, Ignaccolo-Zenide, e përmendur më sipër, § 94; Iglesias Gil dhe A.U.I., , e përmendur më sipër, § 48; dhe Nuutinen v. Finland, nr. 32842\96, § 127, ECHR 2000-VIII).

52. Në rastet lidhur me ekzekutimin e vendimeve në fushën e së drejtës familjare, Gjykata ka arsyetuar se kriteri vendimtar është nëse organet kompetente shtetërore kanë marrë të gjitha masat e nevojshme për të lehtësuar ekzekutimin e vendimeve, siç mund të kërkohet në mënyrë të arsyeshme në rrethanat e veçanta të çdo çështjeje (shih Hokkanen v. Finland, vendimi i datës 23 shtator 1994, Seria A nr. 299-A, f. 22, § 58; Ignaccolo-Zenide, i përmendur më sipër, § 96; Nuutinen, siç është përmendur më sipër, § 128; dhe Sylvester, përmendur më sipër, § 59).

53. Në çështje të këtij lloji përshtatshmëria e një mase gjykohet nga shpejtësia e ekzekutimit të saj, meqenëse kalimi i kohës mund të ketë pasoja të pandreqshme për marrëdhëniet ndërmjet fëmijës dhe prindit, i cili nuk jeton me të. Gjykata tërheq vëmendjen se neni 11 i Konventës së Hagës mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijës i datës 25 tetor 1980 (ku Shqipëria nuk është palë) kërkon nga organet gjyqësore apo administrative kompetente të veprojnë shpejt, lidhur me procedurat për kthimin e fëmijëve dhe çdo mosveprim që zgjat më shumë se gjashtë javë, mund të çojë në nisjen e një ankimimi për të kërkuar arsyet e vonesës (shih Ignaccolo-Zenide, i përmendur më sipër, § 102).

54. Gjykata ka arsyetuar gjithashtu se megjithëse masat shtrënguese ndaj fëmijëve nuk janë të dëshirueshme në këtë fushë delikate, përdorimi i sanksioneve nuk duhet të përjashtohet në rast të një sjelljeje të paligjshme nga prindi me të cilin jeton fëmija (shih Ignaccolo-Zenide, i përmendur më sipër, § 106).

55. Gjykata thekson se Konventa duhet të zbatohet në përputhje me parimet e së drejtës ndërkombëtare, në veçanti me ato lidhur me mbrojtjen ndërkombëtare të të drejtave të njeriut (shih Streletz, Kessler and Krenz v. Germany (GC), nos. 34044\96, 35532/97 and 44801/98, § 90, ECHR 2001-II, and Al-Adsani v. the United Kingdom [GC], nr. 35763/97, § 55, ECHR 2001-XI). Si rrjedhim, Gjykata arsyeton se detyrimet pozitive që neni 8 i Konventës parashtron për Shtetet Kontraktuese përsa i përket ribashkimit të prindit me fëmijën e tij\saj duhet të interpretohen në lidhje me Konventën e Hagës të datës 25 tetor 1980 (shih Ignaccolo-Zenide, i përmendur më sipër, § 95).

b) Zbatimi i parimeve të përgjithshme për këtë çështje

56. Gjykata vëren së pari, që marrëdhëniet ndërmjet ankuesit dhe së bijës i përkasin sferës së

jetës familjare në bazë të nenit 8 të Konventës.

57. Ngjarjet që po shqyrtohen në këtë rast, në masën që ato bëjnë përgjegjës shtetin e paditur, çojnë qartë në ndërhyrjen në të drejtën e ankuesit për respektimin e jetës familjare, meqenëse neglizhimi për të ekzekutuar vendimin e kujdestarisë dëmtoi gëzimin e pranisë të së bijës.

58. Pavarësisht se nga zhvillimet e fundit procesi i kujdestarisë në fjalë është rihapur dhe është në zhvillim e sipër, Gjykata nënvizon se vendimi i kujdestarisë i 4 shkurtit 2004 ka qenë i vlefshëm dhe mbeti pa u ekzekutuar përafërsisht dy vjet. Prandaj Gjykata duhet të përcaktojë nëse organet kompetente kombëtare morën masat e nevojshme dhe të duhura për të lehtësuar ekzekutimin e vendimit që po shqyrtohet.

59. Lidhur me çështjen aktuale, Gjykata vëren se procedurat e ekzekutimit të vendimit në favor të ankuesit kanë mbetur pezull që në prill 2004. Ajo fillimisht konstaton se kjo situatë nuk është krijuar në asnjë mënyrë për shkak të ankuesit, i cili u është drejtuar organeve shtetërore kompetente për t'i dhënë fund asaj dhe ka marrë masa sistematikisht për të garantuar kthimin e së bijës.

60. Vetëm në prill 2005, më shumë se një vit pas marrjes së vendimit të kujdestarisë, përmbaruesit kërkuan nga policia t'u jepte informacion rreth vendndodhjes së F.M.-së dhe së bijës. Ndërsa të gjitha këto përpjekje për ekzekutimin e vendimit ndodhën brenda një periudhe prej katër muajsh në vitin 2005, nuk mund të vërehet i njëjti kujdes lidhur me periudhën vendimtare menjëherë pas marrjes së vendimit të kujdestarisë. Siç u përmend më sipër, vetëm në janar 2005, përmbaruesit filluan hetimin e vendndodhjes së F.M.-së. Më tej duhet nënvizuar se nuk u mor asnjë masë pas muajit maj 2005.

61. Gjykata vëren se nuk është parashtruar asnjë shpjegim i pranueshëm për të justifikuar këto vonesa. Në mënyrë të ngjashme, nuk është dhënë asnjë shpjegim nga ana e autoriteteve shtetërore për mosveprimin e organeve kompetente kur u siguruan se F.M. jetonte në Greqi. Duhet nënvizuar në këtë aspekt se edhe ankuesi, edhe familja e F.M.-së kishin njoftuar organet kompetente, edhe gjatë seancës së kujdestarisë, se F. M. jetonte në Athinë si emigrante ekonomike.

62. Gjykata konsideron se argumentet e autoriteteve shtetërore për statusin joligjor të F.M.-së në Greqi janë spekulative. Autoritetet nuk morën masa të përpiqeshin të konfirmonin vendndodhjen e F.M.-së dhe të së bijës nga autoritetet greke, një mundësi e garantuar nga marrëveshja dypalëshe ndërmjet dy vendeve.

63. Autoritetet shtetërore pretendonin se pamundësia e ekzekutimit të vendimit në fjalë rezultoi nga fakti se fëmija nuk ishte më në Shqipëri, një situatë e cila ishte shkaktuar pjesërisht nga pamundësia e ankuesit për të kërkuar masa urgjente gjatë procedurave të kujdestarisë.

64. Megjithatë, duket se përpjekjet e ankuesit për të njoftuar autoritetet për rreziqet e rrëmbimit të fëmijës, kishin kaluar pa u vënë re. Gjykata arsyeton se mosveprimi i ankuesit për të kërkuar një masë të ndërmjetme nuk mund të merret për të shfajësuar autoritetet nga detyrimet e tyre përsa i përket ekzekutimit të vendimeve, meqenëse janë ata që ushtrojnë autoritetin publik dhe kanë mjetet në dispozicion për të kapërcyer problemet në fushën e ekzekutimit të vendimeve. Veç kësaj, ankuesi nuk mund të fajësohej pse nuk iu drejtua gjykatave greke, pasi marrëveshja dypalëshe për këtë çështje kërkonte qartë përfshirjen e Ministrive të Drejtësisë të të dyja vendeve në ekzekutimin e vendimeve të kujdestarisë në territorin e tyre (shih paragrafin 33 më sipër). Siç është përmendur dhe më sipër, autoritetet shtetërore nuk kanë shpjeguar për sqarimin e Gjykatës se cilat masa, nëse ka ndonjë, janë marrë në bazë të marrëveshjes për të siguruar kthimin e vajzës së ankuesit nga Greqia të paktën për të gjetur vendndodhjen e F.M.-së.

65. Gjykata vijon se gama e gjerë e masave ligjore që është zbatuar nga autoritetet shqiptare për të vepruar në përputhje me parimet e shtetit ligjor, si dhe traktateve europiane dhe ndërkombëtare, nuk siguron masa efikase për të siguruar ribashkimin e prindërve me fëmijët si në rastin e ngjashëm me atë të ankuesit. Në veçanti, nuk ka mjete të brendshme të veçanta për të parandaluar ose ndëshkuar rastet e rrëmbimit të fëmijëve nga territori i Shqipërisë (shih paragrafët 34 si më sipër). Aktualisht, Shqipëria nuk është Palë në Konventën e sipërpërmendur të Hagës dhe ende nuk e ka zbatuar Konventën e OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijëve të datës 20 nëntor 1989 (shih paragrafët 31 dhe 32 si më sipër).

66. Gjykata tërheq vëmendjen se Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut nuk u vendos shteteve detyrimin për t'i ratifikuar konventat ndërkombëtare. Sidoqoftë, ajo u kërkon atyre të marrin të gjitha masat e nevojshme, në zgjedhjen e tyre të lirë, për të siguruar të drejtën e individit, të garantuar nga neni 8 i Konventës dhe në veçanti për të siguruar ribashkimin e prindërve me fëmijët e tyre në përputhje me një vendim të formës së prerë të gjykatës vendase.

67. Pavarësisht nga mosratifikimi i instrumenteve përkatëse ndërkombëtare në këtë fushë nga Shqipëria, Gjykata konstaton se sistemi ligjor shqiptar, në këtë fazë, nuk siguron ndonjë kuadër alternativ që i jep ankuesit mbrojtjen e duhur praktike dhe efektive që kërkohet nga detyrimi pozitiv i shtetit sipas nenit 8 të Konventës.

68. Në rrethanat e kësaj çështjeje, pavarësisht nga marzhi i vlerësimit të shtetit të paditur, Gjykata konkludon se përpjekjet e autoriteteve shqiptare nuk ishin të duhura dhe as efikase për të përmbushur detyrimin e tyre pozitiv sipas nenit 8.

69. Si rrjedhim, është shkelur neni 8 i Konventës.

II.SHKELJET E PRETENDUARA TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

70. Ankuesi u ankua se autoritetet shqiptare nuk mundën të vepronin në përputhje me vendimin e formës së prerë që i garantonte atij kujdestarinë për të bijën. Ai u mbështet në nenin 6 § 1 të Konventës, i cili në pjesët e tij përbërëse nënvizon si më poshtë:

"Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht,...nga një gjykatë..., e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile,..."

71. Autoritetet shtetërore e kundërshtuan këtë argument.

72. Gjykata vëren se ky ankim lidhet me atë të shqyrtuar më sipër dhe si rezultat duhet të deklarohet gjithashtu i pranueshëm.

73. Gjykata rithekson ndryshimin në natyrën e interesave në bazë të neneve 6 dhe 8 të Konventës. Ndërsa neni 6 ofron garanci procedurale, që do të thotë "e drejta për t'iu drejtuar një gjykate" në përcaktimin e "të drejtave dhe detyrimeve civile" të individit, Neni 8 i shërben një qëllimi më të plotë, sigurimin e respektit të duhur, ndër të tjera, për jetën familjare. Ndryshimi ndërmjet qëllimit të ndjekur nga garancitë përkatëse të ofruar nga neni 6 dhe 8 mund të justifikojnë, në lidhje me rrethana të veçanta, shqyrtimin e të njëjtit grup faktesh sipas të dy neneve (shih, për shembull, McMichael v. The United Kingdom, vendimi i datës 24 shkurt 1995, Seria A nr. 307-B, f. 57, § 91, dhe Sylvester, i përmendur më sipër, § 76).

74. Megjithatë, në rastin konkret dhe duke marrë parasysh konkluzionet lidhur me nenin 8 (shih paragrafin 69 më sipër), Gjykata arsyeton se nuk është e nevojshme të shqyrtohet nëse në rastin konkret ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 (shih, ndër autoritetet e tjera, Sylvester, i përmendur më sipër, § 77).

III.SHKELJE TË TJERA TË PRETENDUARA TË KONVENTËS

75. Ankuesi u ankua në bazë të nenit 6 § 1 për dështimin e autoriteteve për të filluar procesin penal kundër A.C., i cili, siç pretendonte ai, kishte falsifikuar dokumentet që kishin ndihmuar ish-bashkëshorten e tij të rrëmbente të bijën. Së fundmi, duke iu referuar falsifikimit të certifikatës së lindjes të së bijës, ankuesi u ankua në bazë të neneve 12, 13, dhe 17, pa dhënë arsyet e duhura.

76. Përsa i përket ankimit të ankuesit sipas nenit 6 § 1, Gjykata thekson se e drejta për të nisur proces penal kundër personave privatë nuk garantohet nga Konventa (shih X v. the Federal Republic of Germany, nr.7116\75, vendimi i Komisionit i datës 4 tetor 1976, Decisions and Reports 7, f. 91, dhe B.C. v. Slovakia (Dhjetor), nr. 11079\02, 14 mars 2006 dhe gjithashtu Perez v. France (GC), nr.47287\99, § 70, ECHR 2004-I). Ajo vijon, se ky ankim nuk përputhet*, ratione materiae*, me dispozitat e Konventës sipas kuptimit që përmban neni 35 § 3 dhe duhet të mos pranohet në përputhje me nenin 35 § 4.

77. Përsa i përket faktit se ankuesi u ankua për shkelje të neneve 12, 13 dhe 17 të Konventës pa dhënë detaje të mëtejshme, Gjykata arsyeton se çështja është tërësisht e pabazuar. Si rrjedhim, ky ankim nuk pranohet dhe çështja duhet të pushohet në përputhje me nenin 35 § § 3 dhe 4 të Konventës, duke qenë se është haptazi e pabazuar.

IV.ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

78. Neni 41 i Konventës parashikon:

"Kur Gjykata konstaton shkelje të konventës ose të protokolleve të saj, dhe e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese mundëson vetëm ndreqjen e pjesshme të pasojave të shkaktuara nga shkelja, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar."

A. Dëmi

79. Ankuesi pretendonte 10 000 euro dëmshpërblim (në para), që do të kompensonin humbjen e tij të pagave dhe mundësive të punës, dhe 15 000 euro dëmshpërblim jomaterial për shqetësimet e

shkaktuara si rezultat i pamundësisë së ekzekutimit të vendimit të ribashkimit të tij me të bijën.

80. Autoritetet shtetërore kundërshtuan pretendimet e ankuesit, meqenëse sipas tyre aplikimi ishte i papranueshëm. Ata nuk dhanë ndonjë argumentim lidhur me shumat e pretenduara për dëmshpërblim material dhe jomaterial.

81. Gjykata nuk dallon ndonjë lidhje shkakësore ndërmjet shkeljes së evidentuar dhe dëmit material të pretenduar; prandaj ajo e hedh poshtë këtë pretendim.

82. Përsa i përket dëmit jomaterial, Gjykata nuk sheh ndonjë arsye për të mos besuar se ankuesi ka vuajtur si rezultat i mosekzekutimit të vendimit të formës së prerë në fjalë dhe se shpërblimi i drejtë do të kufizohet vetëm me konstatimin e shkeljes.

83. Duke pasur parasysh shumat e dhëna për rastet e krahasueshme (shih, për shembull, Ignaccolo-Zenide, siç u përmend më sipër, § 117; Hokkanen, siç u përmend më sipër, f. 27, § 77; shih gjithashtu, mutatis mutandis, Elsholz v. Germany (GC), nr. 25735\94, § 71, GJEDNJ 2000-VIII, dhe Kutzner v. Germany, nr. 46544\99, § 87, GJEDNJ 2002-I), dhe duke bërë një vlerësim mbi baza të drejta sipas nenit 41, Gjykata cakton shumën prej 15 000 euro për këtë aspekt.

C. Kostot dhe shpenzimet

84. Ankuesi pretendonte gjithashtu 17 000 euro për koston dhe shpenzimet e kryera para gjykatave vendase dhe Gjykatës Europiane.

85. Autoritetet shtetërore nuk shprehën ndonjë qëndrim.

86. Në bazë të praktikës së Gjykatës, një ankues ka të drejtën e rimbursimit të kostos së shpenzimeve të tij vetëm për shpenzimet e kryera realisht dhe që kanë qenë të domosdoshme dhe të arsyeshme. Në rastin konkret, duke iu referuar marrjes së informacionit dhe kritereve të shprehura më sipër, Gjykata e konsideron të arsyeshme të japë shumën prej 10 000 euro për të gjitha shpenzimet sipas të gjithë zërave.

D.Interesi i vonuar

87. Gjykata e shikon të arsyeshme që interesi i vonuar duhet të mbështetet brenda kursit të dhënë nga Banka Europiane Qendrore, së cilës i shtohen tre pikë përqindje.

PËR KËTO ARSYE , GJYKATA UNANIMISHT

1. Deklaron, ankesat lidhur me nenin 6 § 1 (për mosekzekutimin) dhe nenin 8 të Konventës të pranueshme ndërsa pjesën e mbetur të kërkesës, të papranueshme;

2. *Vlerëson se ka pasur shkelje të nenit* 8 të Konventës;

3. *Vlerëson se nuk ka arsye për të shqyrtuar veçmas ankimin lidhur me nenin* 6 § 1 të Konventës;

4. *Vlerëson*

a) që shteti përkatës, në përputhje me nenin 44 § 2 të Konventës, duhet t'i paguajë ankuesit, brenda tre muajve që vendimi merr formë të prerë, shumat e mëposhtme, për t'u konvertuar në valutën vendase të shtetit përkatës, me kursin e këmbimit të zbatueshëm në datën e shlyerjes, plus çdo taksë që mund të jetë e tatueshme.

i) 15 000 euro (pesëmbëdhjetë mijë euro)lidhur me dëmin jopasuror;

ii) 10 000 euro (dhjetë mijë euro) lidhur me koston e shpenzimeve;

b) që nga skadimi i afatit të mësipërm tremujor deri në shlyerje, interesi i thjeshtë do të jetë i pagueshëm mbi shumat e mësipërme në një normë të barabartë me normën marzhinale të huadhënies të Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhës së mospagimit, plus tre pikë për qind;

5. Hedh poshtë pjesën e mbetur të kërkesës së ankuesit për shpërblim të drejtë.

6. Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 12 dhjetor 2006, sipas neneve 77 § § 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

T.L. Early
Regjistruesi

Nicolas Bratza
Presidenti